

## „KRYENGRITJA E DIBRËS-OHRIT E SHTATORIT TË VITIT 1913“ SIPAS DOKUMENTEVE SERBE

Muzafer BISLIMI<sup>1</sup>

<sup>1</sup>*Institute of National History, University "Ss. Cyril and Methodius" - Skopje*

<sup>\*</sup>*Corresponding author e-mail: mu\_bislimi@yahoo.com*

### Përmbledhje

Nga Konferenca e Paqes e Londrës dhe Traktati i Paqes i Bukureshtit i vitit 1913, definitivisht gjysma e strukturës etnike shqiptare do të lihet jashtë nga shteti amë, Shqipëria. Kështu Lëvizja Kombëtare Shqiptare (LKSH) u vu në lëvizje dhe në fund të verës së vitit 1913, shpërtheu një kryengritje kundër pushtimit serb në të cilën u shpreh dhe bashkëpunimi me komitetet maqedonase (bullgare), pra VMRO-në dhe rrethin e saj revolucionar të Ohrit, me në krye Milan Matovin dhe Petar Çaulevin, kundër pushtetit serb. Kryengritja u mbështet nga Bullgaria, e cila, pas humbjeve në luftën e Dytë ballkanike dhe Marrëveshjes së Paqes të Bukureshtit, shpresonte se duke ndihmuar kryengritjen, do të sillte ndërhyrjen e Fuqive të Mëdha dhe kështu një konferencë të re paqeje për Ballkanin.

Kështu, u vendosën kontakte midis VMRO-së dhe Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, por u vendosën edhe kontakte me qeverinë shqiptare të Ismail Qemalit dhe në fund të qershorit 1913, diku në Vlorë, u mbajt një mbledhje ku morrën pjesë Ismail Qemali, Bajram Curri, Esat Pashë Toptani, Irfan Bej Ohri, Milan Matov, Petar Çaulev dhe oficerë e ushtarakë bullgarë. Qeveria shqiptare që doli nga pavarësia e Shqipërisë më 28 nëntor 1912 dhe njohja e saj nga Konferenca e Paqes në Londër dhe Paqja e Bukureshtit e vitit 1913, me një kufi ende të pacaktuar, ishte e brishtë dhe e pafuqishme për t'u dhënë ndonjë mbështetje të madhe kryengritësve, përveç mbështetjes logjistike dhe mbështetje minimale. Ajo priste ndihmë nga Bullgaria, e cila, sipas kryetarit serb të Dibrës, premtoi ndihmë për mijëra pushkë dhe municione, të cilat në sasi të tilla nuk u erdhën asnjëherë kryengritësve në Dibër dhe në rajonin e Ohrit-Strugës.

Nga Konferenca e Paqes e Londrës dhe Traktati i Paqes i Bukureshtit i vitit 1913, definitivisht gjysma e strukturës etnike shqiptare do të lihet jashtë nga shteti amë, Shqipëria. Kështu Lëvizja Kombëtare Shqiptare (LKSH) u vu në lëvizje dhe në fund të verës së vitit 1913, shpërtheu një kryengritje kundër pushtimit serb në të cilën u shpreh dhe bashkëpunimi me komitetet maqedonase (bullgare), VMRO-në dhe rrethin e saj revolucionar të Ohrit, me në krye Milan Matovin dhe Petar Çaulevin, kundër pushtetit serb.

Kryengritja u mbështet nga Bullgaria, e cila, pas humbjeve në luftën e Dytë ballkanike dhe Marrëveshjes së Paqes të Bukureshtit, shpresonte se duke ndihmuar kryengritjen, do të sillte ndërhyrjen e Fuqive të Mëdha dhe kështu një konferencë të re paqeje për Ballkanin. Kështu, u vendosën kontakte midis VMRO-së dhe Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, por u vendosën edhe kontakte me qeverinë shqiptare të Ismail Qemalit dhe në fund të qershorit 1913, diku në Vlorë, u mbajt një mbledhje ku morrën pjesë Ismail Qemali, Bajram Curri, Esat Pashë Toptani, Irfan Bej Ohri, Milan Matov, Petar Çaulev dhe oficerë e ushtarakë bullgarë.

Qeveria shqiptare që doli nga pavarësia e Shqipërisë më 28 nëntor 1912 dhe njohja e saj nga Konferenca e Paqes në Londër dhe Paqja e Bukureshtit e vitit 1913, me një kufi ende të pacaktuar, ishte e brishtë dhe e pafuqishme për t'u dhënë ndonjë mbështetje të madhe kryengritësve, përveç mbështetjes logjistike dhe mbështetje minimale. Ajo priste ndihmë nga Bullgaria, e cila, sipas kryetarit serb të Dibrës, premtoi ndihmë për mijëra pushkë dhe municione, të cilat në sasi të tilla nuk u erdhën asnjëherë kryengritësve në Dibër dhe në rajonin e Ohrit-Strugës.

Në atë mbledhje u vendos që të krijohej një komitet i përbashkët shqiptaro-maqedonas (bullgar)<sup>318</sup>, me qendër në Elbasan. Kryetar u emërua Irfan Bej Ohri dhe nënkryetar Petar Çaulev, i cili me origjinë ishte shqiptar ortodoks nga Ohri dhe e fliste shumë mirë gjuhën shqipe. Sipas vendimeve të asaj kryengritje, ajo duhej të ngrihej në tetor të vitit 1913, për të shfrytëzuar terrenin dhe kushtet atmosferike në atë periudhë që të kishte sukses dhe ushtritë serbe të mos reagonin në përputhje me rrethanat.<sup>319</sup>

LKSH edhe para kësaj marrëveshje po vlonte, sepse ushtritë serbe kishin depërtuar thellë në territorin e Shqipërisë, shumë më thellë se kufijtë e Shqipërisë londineze, por duke qenë se ende nuk ishin shënuar përfundimisht (Komisioni për Kufirin Shqiptar po priste që të dilte në terren) donin të depërtonin sa më thellë në territorin shqiptar, me pretekstin e mbrojtjes së territoreve të tyre të dhëna nga Konferenca e Londrës. Me ushtritë e tyre depërtuan pothuajse në qytetin e Lezhës në bregdetin shqiptar, Lumë, Peshkopi dhe në Mat, Pogradec dhe gati deri në Elbasan.

Që kryengritja e armatosur të ishte më e suksesshme që në fillim, LKSH gjeti terren të përshtatshëm në këto zona kufitare të banuara nga një numër i madh i popullatës shqiptare dhe tani të pushtuara nga ushtritë serbe. Prandaj u organizua informimi dhe përgatitja paraprake e popullsisë shqiptare për kryengritjen e ardhshme. Burimet serbe këto veprime shqiptare i quajtën agjitacion në popullatën shqiptare për t'u ngritur kundër pushtetit serb në shenjë e dhënë. Armët siguroheshin nga Shqipëria dhe vende të tjera mike me të cilat ishte armatosur popullsia vendase. “Për të pasur sukses kryengritja, në territorin shqiptar u mbledhën dhe u organizuan grupe të forta shqiptare, detyra e të cilave ishte të hynin në territorin tonë, me qëllim që të tërhiqnin popullsinë shqiptare drejt tyre dhe kështu të forcoheshin për t'u bërë pronarë të këtyre trojeve”- thuhet në dokumentin serb.<sup>320</sup>

Vetë raportet serbe konfirmojnë se shqiptarët në këto treva ishin gati për kryengritje kundër okupatorit serb. “Kush i kishte armët të fshehura, e kishte shumë, i nxirrte dhe doli në luftë. Për ata që nuk kishin armë, u dhanë armë të sjella nga Shqipëria. Udhëheqësit që kishin ndikim në disa rajone dërguan emisarët e tyre me urdhra që çdo mashkull i rritur, pavarësisht nëse kishte armë apo jo, të shfaqej në vendet e caktuara. Këtu ata që nuk kishin armë u shpërndaheshin me kuaj me sënduk që ishin mbushur nga furnizimet e ndryshme nga jashtë, si dhe municione.”<sup>321</sup>

Kryengritësit shqiptarë u grupuan në katër grupe. Grupi i parë u mbledh rreth burimeve të lumit Shkumbin-Elbasan me plan për të vepruar në dy drejtime, njëri përmes Qafë Thanës drejt Strugës dhe Ohrit dhe i dyti më i vogël veçoi në afërsi të Pogradecit. Në këto grupe vepruan dhe u bashkuan me kryengritësit shqiptarë shumë vojvodë dhe komitë mes të cilëve edhe Petar Çaulev i cili me njësitë e tij vepronte drejt Strugës dhe Ohrit.

<sup>318</sup> Në këto dokumente, autoritetet serbe përdorin të dy termat, maqedonas dhe bullgar. Shumë shpesh në raportet për VMRO-në përmendet si Komiteti Maqedonas, dhe diku përdoret termi bullgar, Bullgari dhe shumë shpesh bullgarash, që evidenton popullsinë që dikur ishte e prirur për Ekzarkinë Bullgare dhe propagandën bullgare. Pra, këta emra i referohen popullatës vendase ortodokse që u rebelua kundër pushtetit serb në bashkëpunim me Lëvizjen Kombëtare Shqiptare dhe qeverinë shqiptare në Vlorë dhe qeverinë bullgare.

<sup>319</sup> ASHRMV.MF.465, Referat i MPB Serbe mbi Kryengritjen e Dibrës.

<sup>320</sup> ASHRMV.MF.475, Raport i Gjeneralishtabit serb për situatën në teren i kërkuar nga MPJ serbe. F.1

<sup>321</sup> ASHRMV.MF.475, Raport i Gjeneralishtabit serb për situatën në teren i kërkuar nga MPJ serbe. F.1-2

Grupi i dytë u përqendrua në Mat dhe u nis drejt Peshkopisë, Dibrës dhe më tej drejt Mavrovës, Gostivarit dhe Kërçovës. Grupi i tretë vepronte nga Isgllavë, nën udhëheqjen e Elez Isufit dhe vepronte në drejtim të Ujmishtit dhe Prizrenit, kurse grupi i katërt u mbledh në Krasniqë dhe Gash, por për shkak të mosmarrëveshjeve midis prijësve, u shpërnda dhe nuk veproi fare. Sipas këtyre burimeve, numri i përgjithshëm i kryengritësve shqiptarë ishte rreth 10.000 ushtarë.<sup>322</sup> Shumë nga këto dokumente analizojnë Kryengritjen e Dibrës, nxitësit, mbështetjen, taktikat e formimit, kanalet, furnizimet, logjistikën, armatimin, etj. Ka edhe telegrame të ndryshme, dërgesa, informacione, kërkesa, urdhra, nga autoritetet civile dhe ushtarake serbe, korrespondenca të ndryshme ndërmjet autoriteteve të tilla serbe etj.

Para, gjatë dhe pas kryengritjes, autoritetet serbe konfiskuan shumë letra nga korrespondenca midis kryengritësve shqiptarë, shpalljet e Petar Çaulevit drejtuar popullatës për bashkimin e popullsisë së Strugës dhe Ohrit në kryengritjen shqiptare, një letër të Riza Beut nga Dibra drejtuar vëllait të tij Shaqir Beut, korrespondenca e ndryshme e Qeverisë së Përkohshme të Dibrës në krye me Sefedin Pustinën me njësitë e saj në terren e të tjera. Veçanërisht duhet theksuar se në një letër të tillë gjejmë për herë të parë një vulë ovale (të rrumbullakët) të Qeverisë së Përkohshme të Dibrës, ku shkruhet me germa osmane-turke: “QEVERIA E PËRKOHSHME E DIBRËS”.<sup>323</sup>

Autoritetet serbe përdornin gjithashtu informacione nga agjentët e tyre në terren, të infiltuar ose të rekrutuar nga radhët e kryengritësve dhe të kontaktuar me kode. Autoritetet serbe ishin veçanërisht të interesuara për krerët e kryengritjes, kështu që në një raport, shumica e raportit iu kushtua krerëve shqiptarë të kryengritjes, ku secili prej tyre përmendet dhe analizohet në detaje - gjithsej 32 udhëheqës: Isa Boletini, Ismail Qemali, Bajram Curri, Riza-bej Gjakova, Shaqir-beu, Riza-bej Dibra, Sefedin Pustina, Ekrem Cami, Halil Kausha, Malic Kratishta, Ilaz Efendi, Iljaz Jusufi, Ahmed-beu nga Mati, Alil Jatani, Halil Kalishta, Selman Alija, Mustafa-bej Dibra, Xhelal-beu, Elez Jusufi, Qazim Lika, Isam Dani, Mamut Biçaku, Selim Dema, Riza Ajra, Libash Bemu nga Labunishta, Hasan Efendi, Milan Matev, Petar Çaulev, Zenel -beu, Bajram Daklani, Sadri-aga dhe Hasan Ahmeti e të tjerë.<sup>324</sup>

Veçmas dhe më hollësisht analizohen krerët shqiptarë të kryengritjes, ndërsa liderët maqedonas (bullgarë) si: Milan Matov, Petar Çaulev, Giga Oshavkov e të tjerë janë lënë pas dore dhe vetëm përmenden në disa pjesë.<sup>325</sup> Veprimet luftarake të kësaj kryengritje, sipas këtyre burimeve serbe, filluan më 3 dhe u intensifikuan më 6 dhe 7 shtator dhe më 8 shtator kryengritësit shqiptarë nisën sulmin e përgjithshëm mbi Peshkopinë, e cila u lirua më 9 shtator nga rreth 2000 kryengritës të cilët më pas u ndanë në dy drejtime, një drejt Zhirovnicës dhe tjetri më i fortë drejt Dibrës. Kështu më 10 shtator Dibra bie në duart e rreth 6000 kryengritësve shqiptarë.<sup>326</sup>

Më 11 shtator kryengritësit pushtuan Mavrovën, kurse më 12 shtator guvernatori serb në Manastir njoftoi MPB-në e Serbisë se kryengritësit shqiptarë pushtuan Kërçovën dhe ekziston rreziku për Krushevën, Prilepin dhe Manastirin.<sup>327</sup> Më 13 shtator në Dibër mbërrin vojvoda Giga Oshavkov me 4 komite dhe më herët më 12 shtator nga Shqipëria në Dibër mbërriti Milan Matov, një nga vojvodët kryesorë maqedonas, i cili kontaktoi menjëherë Qeverinë e Përkohshme të Dibrës.

<sup>322</sup> ASHRMV.MF.475, Raport i Gjeneralshtabit serb deri tek MPJ e Serbisë. Gusht-shtator 1913.

<sup>323</sup> ASHRMV.MF.465, Raport i kryetarit serb të Dibrës, Jovan Qirkoviq për Kryengritjen e Dibrës.08.10.1913. . Në shtojcë të këtij puinimi do të jepet një letër e cila ishte dërguar nga Qeveria e përkohshme e Dibrës drejtuar një njësitë të saj në Mavrovë, tek vendi i quajtur Shpella dhe ku vërehet se ata përdornin një vulë ovale me mbishkrim në gjuhën osmano-turke me shkronja arabe: Hukumeti Debresi Muakkat që në përkthim don të thotë: Qeveria e Përkohshme e Dibrës.

<sup>324</sup> ASHRMV.MF.475, Raport i Gjeneralshtabit serb deri tek MPJ e Serbisë, faqja 8-13.

<sup>325</sup> ASHRMV.MF.475, Dokumenti 1 në këtë botim.

<sup>326</sup> ASHRMV.MF.465, Telegramë e Inspektoratit serb të Shkupit drejt MPB të Serbisë.

<sup>327</sup> ASHRMV.MF.465, Dokumentet 18 dhe 19 të këtij botimi.

Një nga proklamatat e tij u kap nga autoritetet qeveritare serbe ku bëhet thirrje popullatës maqedonase (bullgare) që së bashku me shqiptarët t'i bashkohen luftës kundër pushtetit serb për autonomi të këtyre trojeve. Më 13 shtator u morr Struga dhe të nesërmen Ohri u lirua nga çeta e Petar Çaulevit. Tre përfaqësues të organizatës maqedonase, Nestor Popov, Hristo Atanasov dhe Naum Bojaxhiev, iu bashkuan Qeverisë së Përkohshme kryengritëse, e cila u formua në Dibër pas hyrjes së kryengritësve shqiptarë, me në krye Sefedin Pustinën. Nga 32 krerët e Kryengritjes së Shtatorit, në këto raporte serbe analizohen dy krerët bullgarë (maqedonas), Milan Matov dhe Petar Çaulev.

Në raport ka vetëm një rresht për Milan Matovin, ku shkruhet se ai është "komit (çetnik) bullgar, hajdut pa aftësi të mëdha, ndërsa për Çaulevin thuhet në dy rreshta: "Komit bullgar, pa aftësi luftarake.", frikacak, iku para betejës (në Ohër ose Strugë)".<sup>328</sup> Në të gjitha dokumentet serbe që posedojmë, forcat ushtarake dhe shtetërore serbe, kur flasin për komitetet maqedonase, mundohen t'i tregojnë në mënyrën më të keqe të mundshme, si të lëmuar, frikacakë dhe thjesht si marioneta të shtetit bullgar. Madje, Milan Matov konsiderohet si person i afërt i ministrit bullgar të Punëve të Jashtme, Genadiev.<sup>329</sup>

Por në raporte ndihet shumë qartë dhe lehtë frika e madhe që mbretëronte në qarqet serbe për këto poshtërime për një afrim të madh shqiptaro-maqedonas dhe një kryengritje më e madhe e përbashkët kundër sundimit të tyre të dhunshëm, sepse në Qeverinë e përkohshme të Dibrës, në krye me Sefedinin Pustinën, u zgjodhën edhe tre përfaqësues nga organizata maqedonase: Nestor Popov, Hristo Atanasov dhe Naum Bojaxhiev.<sup>330</sup>

Në të gjitha këto raporte, edhe pse me përbuzje, prezantohen me saktësi veprimtaria e komitetit shqiptar dhe maqedonas, sidomos kontaktet e Ismail Qemalit, Irfan-beut, Hasan Prishtinës nga ana e shqiptarëve, me Petar Çaulev, Milan Matov, Giga Oshavkov, madje u fol se ka pasur edhe kontakte të Jane Sandanskit me Ismail Qemalin dhe, sipas raportuesit, kreut të Dibrës, J. Çirkovic, këta të dy arritën një marrëveshje, ndonëse asnjëherë nuk u shpall si e tillë, dhe se kjo marrëveshje më pas i është dorëzuar Hasan Prishtinës.

Ngjarjet në fushë konfirmojnë një gjë të tillë, përfundon Ćirković. Hasan-beu, i cili tani është ministër, me dy shokë të tjerë foli dhe negocioi me Sandanskin dhe më pas udhëtuan së bashku për në Sofje.<sup>331</sup> Sipas informacioneve të marra nga terreni dhe të dhënave që tha se i kishte marrë më parë, Qirković flet edhe për bashkëpunimin mes shqiptarëve dhe bullgarëve (maqedonas) në rajonet rebele dhe më gjerë. Ai thotë se bullgarët dërguan në Shqipëri nënkolonelin Markov dhe më pas vojvodën e njohur Milan Matov, Stevani Hoxha dhe tre oficerë të tjerë që ishin me Matovin në Elbasan. Nuk jemi shumë të njohur me atë që u tha dhe çfarë u ra dakord, sepse gjithçka ishte një sekret i madh, por u arrit një marrëveshje dhe deri më tani dihet vetëm kjo:

1. Në mbarë Maqedoninë do të formohen komitete të përbashkëta që do të punojnë për ndarjen e Maqedonisë nga Serbia;
2. Trazira të përbashkëta;
3. Bashkimi i bullgarëve dhe shqiptarëve dhe organizimi i kryengritjes kundër pushtetit tonë;
4. Të fillojë me metoda anarkiste në mënyrë që Evropa të fillojë të interesohet për kauzën e tyre.

"Sigurisht që ka edhe pika të tjera në këtë marrëveshje", thotë Çirkovic, por nuk ka arritur t'i zbulojë për shkak të fshehtësisë së madhe. Se është arritur marrëveshje për bashkëpunim ndërmjet komitetit maqedonas dhe atij shqiptar, e vërtetojnë shumë letra dhe proklamata të

<sup>328</sup> ASHRMV.MF.475, Raport i gjeneralshtabit serb deri tek MPJ serbe. Faqja 12.

<sup>329</sup> ASHRMV.MF.475, Raport i Qirkovićit nga Dibra, 08.10.1913.

<sup>330</sup> ASHRMV.MF.475, Raport i Qirkovićit...08.10.1913

<sup>331</sup> ASHRMV.MF.475, Raport i Qirkovićit.08.10.1913.

Milan Matovit dhe Petar Çaulevit të kapura<sup>332</sup> nga ushtria serbe, të cilat janë edhe pjesë e këtij raporti. Po ashtu vojvoda Petar Çaulev nga Ohri u dërgon shpallje fshatrave jugperëndimore të Tetovës, Slivje, Laktinje, Godivje dhe Vrbjan, për bashkim në kryengritjen shqiptare.<sup>333</sup>

Në gjysmën e dytë të shtatorit 1913, ushtritë serbe me përforcime të mëdha ushtarake në gjak e shtypën kryengritjen dhe më pas filluan një fushatë terrori për të qetësuar këto zona. Në këto dokumente ka shumë raporte për një terror të tillë në fshatrat e rrethit të Manastirit dhe Dibrës.<sup>334</sup> Pas rimarrjes së Dibrës nga ushtritë serbe, një pjesë e madhe e popullatës shqiptare dhe krerëve të saj u tërhoqën me trupat shqiptare në Shqipëri, si dhe shumë maqedonas që bashkëpunuan me kryengritësit shqiptarë, si Hristo Atanasov, Lev Pop Arsov, Stojan. Pop-Arsov, Martin Poparsov, Damjan Josifov dhe Gjorge Blazhev.<sup>335</sup>

---

<sup>332</sup> ASHRMV.MF.475, Raport i Qirkoviqit...08.10.1913.


<sup>333</sup> ASHRMV.MF.475, Raport i Qirkoviqit...08.10.1913.

<sup>334</sup> ASHRMV.MF.465, Dokument 74 dhe 76 të këtij botimi.

<sup>335</sup> ASHRMV.MF.475, Raport i Qirkoviqit...08.10.1913.

KORRESPONDENCË E QEVERISË SË PËRKOHSHME TË DIBRËS ME NJËSITË  
KRYENGRITËSE NË TEREN<sup>336</sup>

CORRESPONDENCE OF THE TEMPORARY GOVERNMENT OF DIBRA WITH THE  
REBEL UNITS ON THE GROUND



Njësisë së ushtrisë tek Shpella (Jama)

Kemi kuptuar se në Mavrovë po bëhet luftë. N[se keni fuqi të mjaftueshme njerzore, ndani 150 luftarë dhe dërgoni në ndihmë njësisë së Mavrovës. Edhe pozicionet tuaja përforconi mirë. Na informoni vëllezër për të rejat tek ju.

Vula (H]k]meti Debresi Muakkat - në gjuhën Osmano-turke)

Qeveria e Përkohshme e Dibrës

12 shtator 1913

Army unit at Cave (Jama)

We have heard that there is a war going on in Mavrovo. If you have manpower, allocate 150 fighters and send them to Mavrov's aid. Also strengthen your positions well. Inform us, brother, about your news.

Seal

Provisional Government of Dibra

12 September, 1913

<sup>336</sup> ASHRMV.MF.465. Letër e dërguar nga Qeveria e përkohshme kryengritëse e Dibrës me në krye Sefedin Pustinën drejtuar një njësi të saj në Mavrovë tek lokaliteti Shpella (Jama). Letra është kapur nga forcat serbe dhe si e tillë gjendet në Arkivin e Serbisë në Beograd ndërsa në formë mikrofilmi gjendet edhe në Arkivin shtetëror të Republikës së Maqedonisë së veriut në Shkup.